

Parim KOSOVA

TË PËRBASHKËTAT DHE TË VEÇANTAT E KONFERENCËS SË BUJANIT DHE LIDHJES SË DYTË TË PRIZRENIT

Gjatë Luftës së Dytë Botërore, forcat politike shqiptare të viseve jashtë Shqipërisë administrative të vitit 1912, ishin munduar t'i shfrytëzojnë rrethanat e reja të krijuara me shembjen e Jugosllavisë dhe vendosjen e pushtetit italian, gjerman dhe bullgar. Këto forca politike qoftë për pragmatizëm ose për idealizëm, ishin të pozicionuara kryesisht në dy grupime politike brenda lëvizjes vendase: e para nacionaliste, ishte për zgjidhjen e çështjes së territorit shqiptar që ka qenë nën okupimin e Mbretërisë së Jugosllavisë, kurse grupimi politik komuniste ishte për zgjidhjen e çështjes së Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit. Të dyja këto rryma edhe pse me rrugë të ndryshëm ishin për bashkimin e territoreve të lartcekura me Shqipërinë.¹ Ideja për themelimin e organizatës politike Lidhja e Dytë e Prizrenit e cila pas kapitullimit të Italisë, do të jetë në ballë të formimit të Shqipërisë etnike dhe mbrojtjen e kufijve të saj prej UNÇ-së së Jugosllavisë, është paraqitur në mbledhjen e mbajtur nga ana e personaliteteve shqiptare më 30 qershor 1943 në Mitrovicë.²

¹ Parim Kosova, *Prizreni gjatë shekujve*, Punim në dorëshkrim, 382.

² Бранислав Божовић - Милорад Вавић, *Сурова времена на Косову и Метохији-квислинзи и колаборација у Другом Светском Рату*, Београд, 1991, 271.

Duke përfituar edhe nga deklaratat zyrtare e Gjermanisë në të cilën Shqipëria shpallet e njohet e lirë, e bashkuar me të gjitha krahinat shqiptare më parë që ishin nën sundimin jugosllav,³ bëri që grupi i politikanëve nacionalistë shqiptarë me z. Xhafer Deva, pa u vonuar më 11 shtator të vitit 1943 në Prizren formuan Këshillin Iniciativë, për thirrjen e një mbledhjeje të përgjithshme popullore me shpirtin dhe me frymën e Lidhjes së Prizrenit, i filluan përgatitjet dhe caktuan datën e mbajtjes së Kuvendit dhe hartuan listën e delegatëve të “viseve të çliruara” dhe të prefekturës së Mitrovicës që do marrin pjesë në këtë eveniment.⁴

Ky grupim politik në Prizren (16-20 shtator), formoi Lidhjen e Dytë të Prizrenit, një organizatë politike kombëtare, e cila u angazhua për bashkimin dhe mbrojtjen e trojeve etnike nga rreziku sllav.⁵ Ndërkohë edhe grupimi politik komunist gjatë Konsultës VI të Komiteti Krahinor të PKJ-së për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, të mbajtur në malet e Sharrit, më 3-5 nëntor 1943 morri vendim për organizimin e Konferencës së Parë të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.⁶ Përgatitjet i kishte bërë Komiteti Krahinor i PKJ-së për Kosovë dhe Dukagjin me ndihmën e Komitetit të rrethit të PKJ-së për Dukagjin të cilët edhe e caktuan datën e mbajtjes së Konferencës.⁷ Kështu ky grupim politik i Lëvizjes Nacional Çlirimtare në Bujan të Malësisë së Gjakovës (31.12.1943 deri më 02.01.1944) mbajti Konferencën Themeluese të Këshillit

³ Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta “Kombi”, E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, 1.

⁴ Tahir Zajmi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit*, Bruxelles, 1964, 35, 36, 38.

⁵ *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPSH-së, 2, Tiranë, 2008, 1298.

⁶ Бранислав Божовић - Милорад Вавић, *Сурова времена на Косову и Метохију-квислинзи и колаборација у Другом Светском Рату*, Београд, 1991, 404; Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997, 138.

⁷ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit, Gurthemeli i shtetësisë së Kosovës (31 dhjetor 1943 dhe 1 e 2 janar 1944)*, Prishtinë 2023, 139.

Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Rrafshin e Dukagjinit.⁸

Kuvendi themelues i organizatës nacionaliste Lidhja e Dytë e Prizrenit u mbajt në lokalet e shkollës “Bajram Curri” në Prizren. Xhandarmeria shqiptare, bënte shërbimin e rojës së nderit.⁹ Kurse Kuvendi themelues i KNÇ u mbajt në kullën e Sali Mani në fshatin Bujan, me përkrahjen e partizanëve të Shqipërisë.¹⁰ Këto dy organizma u themeluan e vepruan në kohë dhe rrethana të njëjta të LDB-së, por me orientime të ndryshme politike. Krerët e Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishin të bindur se Lëvizja antifashiste dhe bashkëpunimi me të ashtuquajturën LNÇJ dhe PKJ do të përfundonte me rivendosjen e pushtetit jugosllav në Kosovë dhe në trevat e tjera shqiptare.¹¹ Me anë të Konferencës së Bujanit udhëheqja krahinore e PKJ-së synonte t’u kundërvihet objektivave të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, që sipas tyre paraqiste rrezik të madh për Lëvizjen Antifashiste në Kosovë. Kjo shprehet edhe në artikullin e Fadil Hoxhës, botuar në gazetën “Lirija”.¹²

Punimet e kuvendeve të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe Konferencës së Bujanit

Atdhetari i dëshmuar z. Musa Shehzade, hapi mbledhjen dhe drejtoi punimet e Kuvendit themelues të organizatës nacionaliste Lidhja e Dytë e Prizrenit, i cili paraqiti arsyet e mbajtjes së këtij kuvendi dhe masat që duheshin marrë për t’i bërë ballë gjendjes kritike në të cilin gjendej atdheu, dhe theksoi nevojën për grumbullimin e të gjitha forcave kombëtare për mbrojtjen e tokës

⁸ *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPSH-së, 2, Tiranë, 2008, 1298.

⁹ Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta “Kombi”, E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, 1. Gazeta “Kombi”, 25 Nëntor 1943, Tiranë, f. 3; Tahir Zaimi, Lidhja II e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës, Bruxelles, 1964, 39.

¹⁰ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 134.

¹¹ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997, 140.

¹² Po aty.

arbërore.¹³ Kurse hapjen e mbledhjes dhe drejtimin e punimeve të Konferencës së Parë të KNÇ-së së Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit e kishte bërë Xhevdet Doda, i cili ishte komandant i Brigadës Kosovaro-Maqedonase. Ai pos tjerash në hapje kishte theksua se: *“Qëllimi i kësaj Konference është që të ndihmojë në bashkimin sa më të fortë të popujve tanë si kusht i parë për forcimin e luftës së armatosur kundër okupatorit dhe tradhtarëve”*.¹⁴

Në kryesinë e punës të Kuvendit të Lidhjes II Prizrenit, zgjidhen kryetar z. Musa Shehzade, nënkryetar z. Aqif Blyta dhe dr. prof. Rexhep Krasniqi, kurse sekretar prof. Bedri Gjinaj.¹⁵ Në kryesinë e punës të Konferencës së Bujanit zgjidhet për kryetar prof. Zekeria Rexha dhe gjashtë veta të tjerë, i cili zgjedhë dhe dy procesmbajtës Hajdar Beg Dushi dhe Rifat Berisha si dhe u zgjodh Këshilli verifikues prej tre anëtarëve. Në Kryesinë e nderit ishin propozuar: Roosvelt, Churchill, Stalin, Enver Hoxha, J. B. Tito etj.¹⁶

Në punën e Kuvendit Themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit kanë marrë pjesë 42 delegatë vetëm nga tokat e liruara: Kosova, Maqedonia Perëndimore (Dibra, Struga, Tetova, Shkupi, Kërçova), Ulqini, Tuzi, Presheva si dhe nga Prefektura e Mitrovicës (Pazari i Ri, Tutini, Podujeva).^{*} I vetmi person që ishte nga Shqipëria e vjetër që morri pjesë në cilësinë e gazetarit ishte Maz’har Sopoti.¹⁷ Në punimet

¹³ Tahir Zaimi, *Lidhja II e Prizrenit dhe lufta heroike e popullit për mbrojtjen e Kosovës*, Bruxelles, 1964, 39; Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta “Kombi”, E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, f. 1.

¹⁴ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 149.

¹⁵ Tahir Zaimi, *Lidhja II e Prizrenit...*, 39; Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta “Kombi”, E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I-Nr. 3 Tiranë, 1.

¹⁶ ASHAK, Fondi: Arkivi i Komitetit Qendror i LKJ-së Beograd. nr. Inventarit 541, viti 1936-1944, kutia nr. 1, dokumenti nr. 4. (dokumente të hulumtuara nga Arkivi i Beogradit fondi Komiteti Qendror i PKJ).

^{*} Prefektura e Mitrovicës sipas Marrëveshjes së Vjenës të prillit të vitit 1941 kishte mbetur jashtë vijës së demarkacionit, pra i takoi zonës së okupacionit gjerman. Por u la të qeveriset prej nëpunësve shqiptarë, por i varën prej Beogradit. Avni Zaimi, Gazeta “Kombi” E Djelë, 28 Nëntor 1943, Viti I - Nr. 1 Tiranë, 2.

Konferencës Themeluese të Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit ishin të ftuar 61 delegatë, morën pjesë 43 delegatë shqiptarë e 6 serbë e malazezë. Munguan 12 përfaqësues nga të cilët 6 shqiptarë.¹⁸ Prej delegatëve pjesëmarrës shqiptarë në Konferencën e Bujanit 11 ose më shumë se një e pesta nuk ishin nga Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit, por ishin nga territori i Shqipërisë dhe Malit të Zi.¹⁹ Kryesisht nga Malësia e Gjakovës dhe nga Plava e Gucia.

Sipas profesorit S. Repishti: “... organizimi, drejtimi dhe fryma që mbizotëroi në Konferencën e Bujanit kanë qenë të dominuar nga elementi komunist. Të tjerët individë ishin patriotë pa parti me opinione personale, por e kishin pranuar rolin udhëheqës të PK-së”.²⁰ Në Kuvendin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit kishin marrë pjesë edhe oficerë gjermanë, njëri prej tyre, kapiteni Ginter Hauzding, i kishte përshëndetur të pranishmit.²¹ Kurse në Kuvendin e Konferencës së Bujanit kishin marrë pjesë edhe dy oficerë të Misionit Ushtarak Anglez, majori Barley.²² Gjatë zhvillimeve të mbledhjeve të Kuvendit

¹⁷ Tahir Zajmi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 38, 44; Rroftë Kosova Shqipetare, Gazeta “Kombi” E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, f. 1; Бранислав Божовић - Милорад Вавић, *Сурова времена на Косову...*, 275-276.

¹⁸ Hakif Bajrami, *Kosova prej Bujanit në Kaçanik*, Prishtinë, 1997, f. 123; Rustem Gjata, *Aspekte politike juridike të Konferencës së Parë të Këshillit Nacionalçlirimtar për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit, Konferenca e Bujanit dhe mëvetësia e Kosovës*, Konferenca e Bujanit (Materiale nga Sesioni shkencor kushtuar 50-vjetorit të Konferencës së Bujanit, mbajtur në Tiranë më 7 janar 1994), Prishtinë, 1998, 18.

¹⁹ Radoshin Rajović, *Autonomia e Kosovës, Studim historiko-juridik*, Prishtinë, 1987, 296; Бранислав Божовић - Милорад Вавић, *Сурова времена на Косову...*, 406; Sami Repishti, *Një qasje për Rezolutën e Bujanit*, Konferenca e Bujanit (Materiale nga Sesioni shkencor kushtuar 50-vjetorit të Konferencës së Bujanit, mbajtur në Tiranë më 7 janar 1994), Prishtinë, 1998, 157.

²⁰ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 161.

²¹ Бранислав Божовић - Милорад Вавић, *Сурова времена на Косову...*, 276.

²² Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 154; Fehmi Rexhepi, *Vendimet e Konferencës së Bujanit-frymëzim për pjesëmarrje aktive të shqiptarëve të Kosovës në Luftën Çlirimtare Antifashiste*, Konferenca e Bujanit (Materiale nga Sesioni

të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, gjatë datave 16-20 shtator 1943 pos z. Musa Shehzade kishin mbajtur fjalime edhe z. Shefqet Shkupi, prof. Rexhep Krasniqi, prof. Bedri Gjinaj, z. Jahja Fusha, nënkryetari Aqif Blyta, prof. Bedri Pejani, prof. Rexhep Mitrovica, inxh. Xhafer Deva, prof. Sylejman Aliu, z. Tahir Zaimi (Zajmi) etj.²³

Në referatin e tij Xhafer Deva, kishte theksuar nevojën e përtëritjes së Lidhjes së vitit 1878, ngase përsëri organizimi bëhej për sigurimin e pavarësisë dhe mbrojtjen e kufijve etnikë shqiptarë. Kuvendi e shpalli formimin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit.²⁴ Fjalimin e parë në Konferencën e Bujanit e kishte mbajtur Fadil Hoxha, komandant i Shtabit Kryesor të UNÇ-së dhe AP-së për Kosovën dhe Rrafshin e Dukagjinit. Fjalë përshëndetëse kishte mbajtur Pavle Joviçevići, sekretar i Komitetit Krahinor të PKJ-së për Kosovën. Fjalimi i tij ishte një referat politik, që zgjati dy orë. Pastaj në emër të rinisë përshëndeti Xhafer Vokshi. Në emër të grave antifashiste, si e vetmja grua, përshëndeti Sabrije Vokshi etj.²⁵

Në Kuvendin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit u morën veprime për bashkimin me Shqipërinë të Kosovës, Dibërës, Tetovës, Strugës, Ulqinit, prefekturës së Mitrovicës, Zonës Neutrale dhe viseve tjera shqiptare që ishin edhe nën okupimin bullgar dhe filluan përgatitjet për organizimin politik e ushtarak të vendit prej çdo sulmi të armikut.²⁶ Pra, udhëheqësit e Lidhjes së Dytë të Prizrenit u deklaruan dhe morën masa për të ardhmen e të gjitha trevave shqiptare që kanë qenë nën Mbretërinë Jugosllave. Udhëheqësit e Këshillit Nacionalçlirimtar të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit pohonin se problemi i kufijve midis Shqipërisë dhe Jugosllavisë, të dyja të

Shkencor kushtuar 50-vjetorit të Konferencës së Bujanit, mbajtur në Tiranë më 7 janar 1994), Prishtinë, 1998, 35.

²³ Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta "Kombi", E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, 1.

²⁴ Бранислав Божовић - Милорад Вавић, *Сурова времена на Косову...*, 276.

²⁵ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 150-152.

²⁶ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 40; Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta "Kombi", E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, 1.

pushtuara, do të zgjidhej përfundimisht pas fitores mbi fashizmin.²⁷ Dhe shprehnin vullnetin për të marrë pjesë në luftë kundër pushtuesve nazifashistë për çlirimin e Kosovës dhe viseve të tjera.²⁸ Kështu udhëheqësit e Konferencës së Bujanit u deklaruan vetëm për të ardhmen e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit.

Organet e Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe të KNÇ-së për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit

Më 18 shtator 1943 Kuvendi i Lidhjes së Dytë të Prizrenit si organ më të lartë dhe drejtues e zgjodhi Komitetin Qendror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit.²⁹ Komiteti në fjalë e vazhdoi punën për formimin e organeve të saja në të gjitha qendrat e tokave të liruara. Më vonë organizimi dhe funksionimi i Lidhjes së Dytë të Prizrenit bëhet komfor sipas Statutit të saj të 21 janarit të vitit 1944, ku organin më të lartë sërish e përbënte Kuvendi i Lidhjes me qendër në Prizren dhe përbëhej prej anëtarëve nga një delegat për çdo prefekturë dhe nënprefekturë; Komiteti Qendror, me seli në Prizren përbëhej prej 14 anëtarëve: kryetari, dy nënkryetarët dhe gjithë anëtarët tjerë të Komitetit Qendror zgjidhen prej Kuvendit. Kryetari dekretohet prej Këshillit të Naltë në Tiranë në bazë të propozimit të Kryeministrit.³⁰

Përpos Komitetit Qendror ishin paraparë edhe komitetet e prefekturave me nga shtatë anëtarë, të nënprefekturave me nga pesë anëtarë, të komunave me nga tre anëtarë, kurse funksionet e komiteteve të fshatrave do t'i kryejnë pleqësia (kryepleqtë) e tyre. Të gjitha këto komitete janë autoritete të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe punët administrative të Lidhjes sipas statutit, do t'i kryejnë zyrtarët të

²⁷ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 68.

²⁸ *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPSH-së, 2, Tiranë, 2008, 1298.

²⁹ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 43; Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta "Kombi", E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, 1.

³⁰ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 46-47; Gazeta "Kosova", Organ i Komitetit Kosovar, Viti III, Nr. 51-52-53, Tiranë, Tetuer 1943, 1.

cilët do të emërojnë Lidhja.³¹

Komiteti Qendror i Lidhjes së Dytë të Prizrenit të datës 18 shtator 1943 kishte këtë përbërje: Rexhep Mitrovica - kryetar, Musa Shehzade - nënkryetar, prof. Kolë Margjini - nënkryetar, Sheh Hasan Shehu, Asllan Boletini, Tahir Zaimi, Qazim Bllaca - anëtarë dhe si sekretar Sulejman Aliu.³² Me kalimin e kohës do të kemi ndryshime të Komitetit Qendror. Për shkak se më 4 nëntor 1943 Rexhep Mitrovica (18-26 shtator 1943) u zgjodh kryeministër dhe zëvendësministër i Kulturës popullore të Qeverisë së shtetit shqiptar.³³ Atë e zëvendësoi z. Musa Shehzade, mirëpo për me i dhënë legjitimitet postit të kryetarit, u mbajt në Prizren nga data 17-21 janar 1944 Kuvendi i Dytë i Lidhjes së Dytë të Prizrenit. Në Kuvend u vendos të zgjerohej KQ nga 7 në 14 anëtarë. Kryetar i KQ u zgjodh Bedri Pejani. Nën vartësinë e Komitetit Qendror u vendos Sekretariati, Seksioni Financiar, Kulturo-Arsimor dhe Ushtarak.³⁴

Kuvendi i tretë mbledhet (17-20 qershor 1944) në Prizren, dhe kryetar i Komitetit Qendror të Lidhjes së Dytë të Prizrenit zgjodhi ing. Xhafer Deva, prof. Rexhep Krasniqi nënkryetar, prof. Kolë Margjini nënkryetar, Tahir Zaimi (anëtar dhe sekretar i përgjithshëm), Musa Shehzade, Sheh Hasan Shehu, Asllan Boletini, Mahmut Shaban Pasha, Rexhë Meta, Qazim Bllaca e Esat Berisha - anëtarë. Kuvendi i fundit ka vazhduar punën deri më 17 nëntor 1944, (ditë kurë partizanët e marrin Prizrenin) që nga rrethanat e luftës botërore Komiteti pezullon veprimtarinë e vet për ta vijuar misionin e ngarkuar nga Kuvendi në mërgim.³⁵

³¹ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 46-47; Бранислав Божовић - Милорад Вавић, *Сурова времена на Косову...*, 279.

³² Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 43; Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta "Kombi", E Enjte 23, Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, 1.

³³ Qeveria u Formua prej Z.T Rexhep Mitrovica, Gazeta "Kombi", E Shtunë, 6 nëntor 1943, Viti I - Nr. 23 Tiranë, 1.

³⁴ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën e Dytë Botërore*, Prishtinë, 1997, 190; Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 56.

³⁵ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 56.

Lidhja e Dytë formoi edhe Komitetin e intelektualëve me seli në Prishtinë, me kryetar profesor Ibrahim Kelmendin, në kuadër të Komitetit u themelua edhe Këshilli i Intelektualëve, të cilin e kryesonte Idriz Shahmani avokat.³⁶ Konferenca e Bujanit zgjodhi Këshillin Nacionalçlirimtar për Kosovë dhe Rrafshin e Dukagjinit, që ishte edhe organ më i lartë i pushtetit në këto vise. Formimin e një forumi të tillë, të njëjtë me ata që kishin ngritur po në atë kohë edhe popujt e tjerë të Jugosllavisë, sanksionoi në fakt pozitën e barabartë të Kosovës me krahinat e tjera të Jugosllavisë.³⁷ Këshilli Nacionalçlirimtar kishte 51 anëtarë, kurse Kryesia e Këshillit përbëhej prej 9 vetash në përpjesëtim të drejtë me përbërje nacionale të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit.³⁸ Këshillat nacionalçlirimtarë do të ishin të fshatit, të qytetit, të komunës e të rrethit. Këshillat ilegalë përbëheshin prej 3-5 këshilltarë, ndërsa ata legalë prej 5-11 këshilltarë, varësisht nga madhësia e fshatit, qytetit, komunës apo të rrethit.³⁹

Këshilli Nacionalçlirimtar Komunal përbëhej nga Plenumi dhe nga Këshilli Ekzekutiv (përmbaruesi). Plenumin e Këshillit Nacionalçlirimtar Komunal e përbënin përfaqësuesit e të gjitha fshatrave të asaj komune, pra secili fshat nga një anëtar për çdo këshill nacionalçlirimtar. Këshilli ekzekutiv 5-7 anëtarë të zgjedhur ose nga Plenumi i Këshillit Nacionalçlirimtar Komunal ose në mbledhje të të gjithë këshillave të fshatrave, ose më në fund, në mbledhje të përgjithshme të të gjithë votuesve të asaj komune.⁴⁰ Pas miratimit të Rezolutës u zgjodh Kryesia e Këshillit Nacional Çlirimtar të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, e cila përbëhej nga 9 anëtarë, ku kryetar i Kryesisë u zgjodh Mehmet Hoxha, nënkryetar Rifat Berisha dhe Pavle Joviçević. Kryesia do të kryente punën e një qeverie provizore politike dhe shtetërore. Anëtarë të Kryesisë ishin: Mehmet Hoxha,

³⁶ Бранислав Божовић - Милорад Вавић, *Сурова времена на Косову...*, 288.

³⁷ *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, Akademia e Shkencave e RPSH-së, Tiranë, 2008, 536.

³⁸ Rustem Gjata, *Aspekte politike juridike...*, 18.

³⁹ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 81.

⁴⁰ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 82-83.

Rifat Berisha, Pavle Joviçeviq, Zekerija Rexha, Xhevdet Doda, Milan Zeçar, Fadil Hoxha, Ali Shukriu dhe Hajdar Dushi.⁴¹ Sa i përket përgatitjes intelektuale, udhëheqësit e Lidhjes së Dytë të Prizrenit kishin arsimim më të lartë si dhe provojë në politikë, madje disa që nga koha e Hyrijetit dhe shpalljes së Pavarësisë më 1912.

Aktet normative dhe programet e Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe të KNÇ-së për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit

Më 19 shtator të vitit 1943, të gjithë delegatët, të përcjellë nga populli, shkuan në objektin e Lidhjes së Prizrenit të vitit 1878, e në prani të autoriteteve me solemnitet nënshkruan vendimet e Kuvendit dhe mbajtën fjalime para masës së tubuar Bedri Pejani dhe Tahir Zaimi.⁴² Kuvendi i Parë i Lidhjes së Dytë të Prizrenit autorizoi Xhafer Devën Aqif Blytën dhe I. Lutfiun që të koordinojnë punën me qeverinë shqiptare në Tiranë.⁴³ Kështu kjo qeveri Statutin e organizatës Lidhja e Dytë e Prizrenit, e aprovoi në mbledhjen e mbajtur më 21 janar 1944. Statuti në fjalë përbëhej prej 22 neneve, ishte i formuluar ashtu që kishte dhe karakter programor. Në hartimin e këtij dokumenti ishin angazhuar edhe dy juristë nga Tirana, Koqi Tasi dhe Teki Selenica. Statuti pas aprovimit, i është dërguar Këshillit të Naltë të shtetit shqiptar në Tiranë, i cili, sipas sugjerimit të Këshillit të Ministrave, më 14 mars solli dekretin për aprovimin dhe urdhëroi zbatimin e tij. Statuti është nënshkruar nga kryetari Mehdi Frashëri,

⁴¹ ASHAK, Fondi: Arkivi i Komitetit Qendror i LKJ-së Beograd. nr. Inventarit 541, viti 1936-1944, kutia nr. 1, dokumenti nr. 3. (dokumente të hulumtuara nga Arkivi i Beogradit, fondi Komiteti Qendror i PKJ-së); ASHAK, Fondi: Arkivi i Komitetit Qendror i LKJ-së Beograd. nr. Inventarit 541, viti 1936-1944, kutia nr. 1, dokumenti: ПЕЗОЛУЦИЈА, 3. (Dokumente të hulumtuara nga Arkivi i Beogradit fondi Komiteti Qendror i PKJ-së).

⁴² Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta “Kombi”, E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, 1; Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 43.

⁴³ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën...*, 189.

kryeministri Rexhep Mitrovica dhe anëtarët P. Anton Arapi dhe Lef Nosi.⁴⁴

Në programin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit, të miratuar në Kuvendin Themelues, parashikohej mbrojtja e viseve të liruara dhe e kufijve etnikë.⁴⁵ Dhe bashkimin e tokave të banuara nga shqiptarë brenda një shteti të vetëm.⁴⁶ Për këtë komunistët shqiptarë të Kosovës nuk mund të dilnin para popullit me një platformë politike, që nuk premtonte bashkimin me Shqipërinë.⁴⁷ Sipas Rezolutës së Bujanit, Kosova dhe Rrafshi i Dukagjinit është territor i banuar me pjesën më të madhe me popullsi shqiptare, e cila si gjithmonë, ashtu edhe sot dëshiron të bashkohet me Shqipërinë... Rruga e vetme që shqiptarët e Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit që të bashkohen me Shqipërinë është lufta e përbashkët me popujt e tjerë të Jugosllavisë kundër okupatorit dhe shërbëtorëve të tij etj.⁴⁸ Në Rezolutë pos tjerash ceket se në këtë luftë janë krijuar kushtet dhe është bërë i mundshëm formimi i Komitetit NÇ të Jugosllavisë në krye me komandantin e Ushtrisë Nacional Çlirimtare me mareshalin Tito. Ky Komitet përfaqëson garancitë për lirinë e gjithë popujve, të Jugosllavisë dhe pavarësinë e tyre, të barabartë dhe të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje.⁴⁹ Në Konferencën e Bujanit u miratua edhe Proklamata e KNÇ-së së Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit e 2 janarit 1944,

⁴⁴ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 51; Бранислав Божовић - Милорад Вавић, *Сурова времена на Косову...*, 277.

⁴⁵ *Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Kosova në Vështrim Enciklopedik*, Tiranë, 1999, 116.

⁴⁶ Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta “Kombi”, E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I – Nr. 3 Tiranë, 1.

⁴⁷ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 119, 167.

⁴⁸ ASHAK, Fondi: Arkivi i Komitetit Qendror i LKJ-së, Beograd. nr. Inventarit 541, viti 1936-1944, kutia nr. 1, dokumenti: РЕЗОЛУЦИЈА, f. 1. (dokumente të hulumtuara nga Arkivi i Beogradit fondi Komiteti Qendror i PKJ-së).

⁴⁹ ASHAK, Fondi: Arkivi i Komitetit Qendror i LKJ-së Beograd. nr. Inventarit 541, viti 1936-1944, kutia nr. 1, dokumenti: РЕЗОЛУЦИЈА, f. 2. (dokumente të hulumtuara nga Arkivi i Beogradit fondi Komiteti Qendror i PKJ).

drejtuar popujve të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit.⁵⁰ Derisa në Kuvendin themelues të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, u këndua Himni Kombëtar shqiptar,⁵¹ në Konferencën e Bujanit, pas leximit të Rezolutës në gjuhën shqipe dhe serbe. Në fund, të gjithë delegatët, u ngritën në këmbë me grushtin lart e kënduan “Internacionalen”.⁵²

Kundërvëniet ndaj Lidhjes së Dytë të Prizrenit, Konferencës së Bujanit dhe KQ i PKJ-së dhe qëndrimi i PKSH-së

Autoriteti dhe përkrahja që gëzonte në popull si dhe veprimtaria e Lidhjes së Dytë të Prizrenit si duket ua kishte çrregulluar mjaft planet forcave komuniste dhe udhëheqësve të Luftës Çlirimtare Antifashiste në Kosovë e Shqipëri.⁵³ Kjo shihet edhe nga një artikull i botuar nga Fadil Hoxha, në gazetën “Lirija-Sloboda” ku e dënonte Lidhjen e Dytë të Prizrenit dhe paralajmëronte konferencën e popujve të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, e cila do të kishte rëndësi më të madhe edhe se ajo e vitit 1878 (Lidhja Shqiptare e Prizrenit).⁵⁴

Nga komunistët kërkohej që t’i përqendronin të gjitha forcat kundër reaksionit që shfaqej me veprimin e organizatave siç ishte “Lidhja e Dytë e Prizrenit” etj.⁵⁵ Në anën tjetër edhe KQ e PKJ përmes një letre të datës 28 mars të vitit 1944, i bënte vërejtje Këshillit Nacionalçlirimtar në lidhje me punën e Konferencës së Bujanit.⁵⁶ I njëjti KQ i PKJ-së më 18 qershor të vitit 1944, e urdhëronte udhëheqjen kosovare: “...të hiqet emri Komiteti Krahinor dhe të mbetet ai qarkor... të hiqet emërtim Rrafshi i Dukagjinit dhe të mbetet

⁵⁰ Hakif Bajrami, *Kosova prej Bujanit...*, 163.

⁵¹ Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta “Kombi”, E Enjte, 23 Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, 1.

⁵² Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 167.

⁵³ Fehmi Rexhepi, *Vendimet e Konferencës së Bujanit...*, 32.

⁵⁴ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 115.

⁵⁵ Hakif Bajrami, *Kosova prej Bujanit...*, 112.

⁵⁶ Po aty, 185.

emri *Metohi*".⁵⁷ Kjo ishte goditje e papranueshme e shqiptarëve pjesëmarrës në Bujan. Enver Hoxha, në letrën që ia dërgon Fadil Hoxhës më 24 mars 1944, e uronte për krijimin e Këshillit të Kosovës e të Rrafshit të Dukagjinit, por nuk e shkruante as edhe një fjalë për vetëvendosjen në pajtim me aspiratën kombëtare të popullit të Kosovës.⁵⁸ Pas një shkrimi fare të shkurtër në Buletinin e PKSH-së "Zëri i popullit" (nr. 33, dt. 2.II.1944) për Konferencën e Bujanit, nuk u fol më për të për afro dyzet vjet nga udhëheqja e Republikës Popullore Socialiste e Shqipërisë.⁵⁹ Në bazë të këtyre veprimeve PKJ kishte arritur të futë një pykë edhe brenda grupimit komunist shqiptar.

Roli i shtypit të kohës

Edhe korrespondentët e gazetave "Kombi", që ishte Organ i Komitetit Ekzekutiv Provizor⁶⁰ dhe asaj "Kosova", që ishte Organ i Komitetit Kosovar, e përcollën dhe botuan rrjedhën e hollësishme të Kuvendit themeluese katërditor të Lidhjes së Dytë të Prizrenit, duke dhënë informata për pjesëmarrësit, apelet, debatet, programin etj.⁶¹ Këto dhe gazetat tjera shqiptare si gazeta "Bashkimi i kombit", që në numrin e saj të parë të botuar më 28 nëntor 1943, shkruajnë edhe për veprimtarinë, luftërat e aktivitetet e Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe e përshkruajnë në hollësi masakrën e Bihorit.⁶² Në kuvend ishte aprovuar dhe vendimi për botimin e gazetës "Lidhja e Prizrenit", e cila botohej një herë në javë.⁶³ Organi i Komitetit Intelktual të Lidhjes së Dytë të Prizrenit ishte gazeta "Lidhja e Prizrenit". Numri i parë i saj u

⁵⁷ Muhamet Shatri, *Kosova në Luftën...*,155.

⁵⁸ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 203.

⁵⁹ Rustem Gjata, *Aspekte politike juridike...*, 22-23.

⁶⁰ Rroftë Kosova Shqiptare, Gazeta "Kombi", E Enjte 23, Shtator 1943, Viti I - Nr. 3 Tiranë, 2. Nr. 2, 3, 4, 8, 10, 12, 15, 17, 19, 20, 22.

⁶¹ Gazeta "Kosova" Organ i Komitetit Kosovar, Tetuer 1943- viti III, Nr. 51, 52, 53, Tiranë, 2.

⁶² Gazeta "Bashkimi Kombit" E Djelë, 28 Nëntor 1943, Viti I – Nr. 1, Tiranë. 1.

⁶³ Бранислав Божовић - Милорад Вајић, *Сурова времена на Косову...*, 276.

botua më 20 mars 1944. Gazetë kjo që shkruante për veprimtarinë e Lidhjes së Dytë e sidomos përmes korrespondentëve përcillte gjendjen në fushat e luftës.⁶⁴ Vlen të cekem artikujt: Ujku në lëkurën e kingjit; Gjithnji po ata; Lidhja II e Prizrenit; Rinisë kosovare; Çka kërkon Kosova; Kujtime nga tragjedia e Bihorit; Rëndësia dhe kuptimi i shërbimit ushtarak; Ideali i Em asht: Shqipnija Ethnike; Nanës Shqipni; Ndeshje sportive; Tri vjet Kosova e çlirume; Rinisë kosovare; Vdekja heroike e Bajraktarit Rugovës Sak Fazlija; T'i përgjigjemi kushtrimit etj.⁶⁵ Të gjithë këta artikuj u shkruan nga penda më të mprehta të kohës dhe nga vetë udhëheqësit e Lidhjes së Dytë. Në anën tjetër në shtypin e tyre shkruanin edhe udhëheqësit e nacionalçlirimtares gjegjësisht të PKJ-së e të PKSH-së. Madje Fadil Hoxha, e kishte kritikuar në gazetën-fletushkën “Lirija-Sloboda” formimin e Lidhjes së Dytë të Prizrenit përmes artikullit “Qëllimet e kolonës së pestë në Kongresin e Prizrenit”.⁶⁶

Në Rezolutën e Bujanit në pjesën e detyrave në pikën gjashtë theksohej që KNÇ për Kosovë dhe Rrafsh të Dukagjinit duhet të shtypë edhe gazetën-organin e saj.⁶⁷ Gazeta-fletushka partizane e Kosovës “Lirija-Sloboda” botoi në gjuhën shqipe dhe serbo-kroate materialet e Konferencës së Bujanit si Rezolutën, Proklamatën dhe telegramet e përshëndetjes si në numrin e saj të janarit të vitit 1944 po edhe te numrat 12, 13, 14, të vitit 1944. Gazeta theksonte edhe se delegatët e Bujanit donin vetëm lirinë dhe të drejtën e vetëvendosjes deri në shkëputje.⁶⁸ Në shtypin e Shqipërisë, në gazetën “Zëri i

⁶⁴ “Lidhja e Prizrenit”, Vjeti I, Nr. 1, 20 mars 1944 Organ i Komitetit Intelktual të Lidhjes II të Prizrenit.

⁶⁵ “Lidhja e Prizrenit”, Vjeti I, Nr. 1, 20 mars 1944; Nr. 2, 27 Mars 1944; Nr. 3, 3 Prill 1944; Nr. 4, 10 Prill 1944; Nr. 8, 7 Maj 1944; Nr. 9 14 Maj 1944; Nr. 10, 21 Maj 1944; Nr. 22, Tetor 1944; Nr. 30, Tetor 1944.

⁶⁶ Бранислав Божовић - Милорад Вапић, Сурова времена на Косову..., 404.

⁶⁷ ASHAK, Fondi: Arkivi i Komitetit Qendror i LKJ-së Beograd. nr. Inventarit 541, viti 1936-1944, kutia nr. 1, dokumenti: РЕЗОЛУЦИЈА, f. 3. (dokumente të hulumtuara nga Arkivi i Beogradit, fondi Komiteti Qendror i PKJ-së).

⁶⁸ Fehmi Rexhepi, Vendimet e Konferencës së Bujanit..., 37; Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 180.

popullit”, në numrin e datës 7 shkurt 1944 është përshëndetur Konferenca e Bujanit për vendimet e marra. Po në muajin shkurt të vitit 1944 u botua edhe një pjesë e rezolutës së Konferencës në gazetën “Bashkimi”, një gazetë e Frontit Antifashist Nacional Çlirimtar.⁶⁹

Veprimtaritë luftarake të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe shuarja e saj

Në nenin e dytë të Statutit të Organizatës Lidhja e Dytë e Prizrenit theksohet se qëllimi i saj është të mbrojë Tokat e Lirue me shqiptare dhe të tjerat që ishin nën okupimin e Jugosllavisë. Për këtë qëllim ajo do të organizojë popullin fizikisht e moralisht.⁷⁰ Forcat e Lidhjes në fund të muajit nëntor të vitit 1943 ishin ballafaquar me çetnikët serbë të Drazho Mihajloviqit në regjionin e Pejës. Në malet e Kollashinit pas 22 ditë luftimesh i shpartallojnë përsëri forcat çetnike. Pa kalua një muaj i shpartallojnë çetat çetnike malazeze të Pavle Gjurishiqit në Murin dhe Çakorr dhe marrin bazën e tyre në Shekullar. Arrijnë të thyejnë sulmin e Drazhistave edhe në Tutin e Pazar të Ri, në gusht të vitit 1944 ngadhënjën në luftën e Hogoshtit të Gjilanit.⁷¹ Lidhja e Dytë ngriti Komitetin e Mbrojtjes së Kosovës. Ky Komitet si detyrë tjetër e kishte edhe formimin e njësisve ushtarake. Komandantë të regjimenteve ishin: major Masar Kryeziu në Pejë, kolonel Fuad Dibra në Prishtinë dhe në Prizren kolonel Qazim Komoni, i cili ishte përgjegjës për gjithë ushtrinë e Komitetit.⁷² Kolonel Fuad Dibra me Regjimentin IV të Prishtinës, në vjeshtën e vitit 1944, në sektor të Podujevës i shkatërroi tri divizione bullgare.⁷³ Në artikullin “Kumtesë lufte” të gazetës “Lidhja e Prizrenit” të tetorit të vitit 1944 shkruan për

⁶⁹ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 203-204.

⁷⁰ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 45.

⁷¹ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 52, 57; Daut Bislimi, *Formacionet politiko-ushtarake në Kosovë 1941-1945*, Prishtinë, 1997, 113.

⁷² Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 115-116.

⁷³ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 53.

luftimet e zhvilluara për lirimin e Junikut dhe thyerjen e fuqive komuniste.⁷⁴

Lidhja formoi edhe Komitetin e Rinisë për Mbrojtjen e Kosovës me qendër në Prishtinë, me kryetar Adem Selimi (Gllavica), komandant i njësiteve ushtarake u emërua Shahsivar Aliu me gradën e majorit,⁷⁵ i cili si komandant i përgjithshëm i rinisë “Për Mbrojtjen e Kosovës” i nxori dy proklamata (13 dhe 26 tetor 1944), ku kërkohej mobilizimi i popullit për mbrojtje të territorit shqiptar.⁷⁶ Shqiptarët nën udhëheqjen e Lidhjes së Dytë luftuan kundër çetnikëve serbo-malazezë të Drazho Mihajloviqit e të Pavle Gjurishiqit dhe pastaj kundër forcave partizane sllavo-komuniste serbe, malazeze, bullgare, maqedonase madje edhe disa njësite shqiptare gjatë viteve 1943-1945.⁷⁷ Pas shpartallimit të drazhistëve fillojnë sulmet e brigadave komuniste partizane serbe, malazeze, bullgare, sllavo-maqedonase etj. Në eliminimin e qëndresës kombëtare shqiptare në Tokat e Lirueme do marrin pjesë rreth 40 000 luftëtarë të LNÇ-së të Jugosllavisë që ishin numerikisht sa një armatë.⁷⁸ Mbas pushtimit të Kosovës e viseve të tjera shqiptare nga të ashtuquajturit partizanë të Jugosllavisë komuniste, përpjekjet dhe luftimet e çetave nacionaliste nuk kanë pushuar gjatë gjithë viti 1945 me ç’rast dhanë jetën mijëra dëshmorë, shumë të tjerë u zunë dhe u pushkatuan nga partizanët jugosllavë e shumë të tjerë kaluan në arrati.

Anulimi i vendimeve të Konferencës së Bujanit

Me qëllim të shuarjes së shpresave të shqiptarëve që Kosova të mos i bashkohej Shqipërisë me qëllim që të shuheshin të gjitha vendimet orientuese të Bujanit është vendosur në Kosovë pushteti

⁷⁴ Gazeta “Lidhja e Prizrenit”, Vjeti I, Nr. 33, Tetor 1944, 1.

⁷⁵ Бранислав Божовић - Милорад Вавић, Сурова времена на Косову..., 286.

⁷⁶ Kopje të Proklamatave i posedojmë në bibliotekën personale.

⁷⁷ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 13.

⁷⁸ Бранислав Божовић - Милорад Вавић, Сурова времена на Косову..., 505.

ushtarak më 8 shkurt 1945.⁷⁹ Më 18 shkurt 1945, në një mbledhje të KQ të PKJ-së në Beograd, u vendos që Kosova t'i bashkëngjitej Serbisë. Për t'i dhënë mbështetje juridike, pas dy muajsh, më 7-9 prill 1945, u organizua mbledhja e jashtëzakonshme e KANÇ të Serbisë dhe pas tre muajsh, më 8-10 korrik 1945 u mbledh një i ashtuquajtur Kuvendi i Këshillit Popullor të Kosovës dhe të Rrafshit të Dukagjinit, i cili në historiografi njihet si “Kuvendi” i Prizrenit. Në të dy këto forume u bënë përpjekje që aneksimi i Kosovës, të paraqitej si shprehje e vullnetit të vet popullit të Kosovës.⁸⁰ Në këtë Kuvend morën pjesë 137 këshilltarë të emëruar nga strukturat përkatëse të pushtetit okupues jugosllav, prej të cilëve vetëm 32 ishin shqiptarë.⁸¹

Më 7 gusht të vitit 1945, Këshilli Antifashist Çlirimtar i Serbisë miratoi aneksimin e qarkut autonom të Kosovës e Rrafshit të Dukagjinit në përbërjen e Republikës së Serbisë. Përfundimisht statusi i Rajonit Autonom të Kosovës u sanksionua në Kushtetutën e RF të Jugosllavisë të janarit të vitit 1946.⁸² *Organi më i lartë i Qarkut Autonom të Kosovës ishte Këshilli Popullor (Kuvendi). Ai zgjodhi Këshillin Ekzekutiv me 18 anëtarë dhe kryetar F. Hoxhën.*⁸³ Prej atëherë është konsideruar se Konferenca e Bujanit dhe të gjitha dokumentet e saj mund të trajtohen vetëm si ngjarje historike ose dokumente historike të LNÇ-së së Kosovës si pjesë përbërëse e LNÇ-së së Jugosllavisë.⁸⁴ Më 13 dhjetor 1988 Dhoma Federative Jugosllave deklaroi Rezolutën e Bujanit si “akt i pavlefshëm”.⁸⁵

⁷⁹ Hakif Bajrami, *Kosova prej Bujanit...*, 231, 247.

⁸⁰ *Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Kosova në vështrim enciklopedik*, Tiranë, 1999, 118-119.

⁸¹ Muhamet Shatri, “Copëtimi i trevave etnike shqiptare në Jugosllavi, Aneksimi i Kosovës nga Serbia”, *Kosova* 27, Prishtinë 2005, 116.

⁸² *Akademia e Shkencave e Shqipërisë - Qendra e Enciklopedisë Shqiptare, Kosova në Vështrim Enciklopedik*, Tiranë, 1999, 119.

⁸³ Muhamet Shatri, *Copëtimi i trevave etnike...*, 119.

⁸⁴ Hakif Bajrami, *Kosova prej Bujanit...*, 280.

⁸⁵ Hakif Bajrami, *Kosova prej Bujanit...*, 186; Sami Repishti, *Një qasje për Rezolutën e Bujanit*, Konferenca e Bujanit (Materiale nga Sesioni shkencor kushtuar

Persekutimet e veprimtarëve të Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe të Konferencës së Bujanit

Në mesin e dëshmorëve të flijuar në fushëbetejë për mbrojtjen e kufijve të Shqipërisë etnike dhe të viktimave të pushkatuara nga pushteti sllavo-komunist dhe shumë të tjerë që u dënuan nga gjykatat jugosllave, janë edhe drejtuesit dhe veprimtarët e organizatës Lidhja e Dytë e Prizrenit. Musa Shehu-Shehzade, në vitin 1944 ngaqë u arrestua po atë natë, e likuiduan.⁸⁶ Bedri Pejani, nga ana e gjyqit popullor të qarkut të Prizrenit, është dënuar me vdekje.⁸⁷ Njëjtë edhe Fuad Dibra është dënuar me vdekje dhe është pushkatuar.⁸⁸ Aqif Blyta, prof. Kolë Margjini nënkryetar i Lidhjes II të Prizrenit. Shyqri bej Ramadani, kryetar i Komitetit Qarkor të Lidhjes II të Prizrenit, Prishtinë, vëllezërit Begolli të Pejës, mulla Nuredin Gjinovci, e shumë të tjerë. Është numri i madh i atyre veprimtarëve që u dënuan me burgime.⁸⁹

Ngjashëm u veprua edhe me kuadrot komuniste dhe antifashiste shqiptare të Kosovës e më gjerë, ata që mbronin, krahas ideve komuniste edhe platformën kombëtare, nga ana e veprimtarëve të PKJ-së filluan të akuzohen dhe të etiketohen si nacionalistë e shqiptaromëdhenj për t'u eliminuar ose likuiduar në forma edhe në mënyra më perfide, si p.sh. Emin Duraku, Xheladin Hana, Xheladin

50-vjetorit të Konferencës së Bujanit, mbajtur në Tiranë më 7 janar 1994), Prishtinë, 1998, 167.

⁸⁶ Parim Kosova, “Shëmbëlltyra e nacionalistit Musa Shehzade (1870-1944)”, Djathta Shqiptare në Mbrojtjen e Shqipërisë Etnike - (3), Prizren-Shkodër, 2006, 506.

⁸⁷ Gazeta “Rilindja”, Prishtinë, Nr. 29, 8 mars 1946, 2.

⁸⁸ Parim Kosova, “Kundërshtimi heroik nga burgu i Prizrenit i Fuat Osman Dibrës”, Djathta Shqiptare në Mbrojtjen e Shqipërisë Etnike - (9), Prizren-Kukës, 2010, 357.

⁸⁹ Tahir Zaimi, *Lidhja e Dytë e Prizrenit...*, 62-65; Parim Kosova, “Veprimtaria atdhetare e mulla Nuredin Gjinovcit”, Djathta Shqiptare në Mbrojtjen e Shqipërisë Etnike - (5), Prizren-Orosh, 2007, 457.

Kurbaliu, Hajdar Dushi, Qemal e Nexhat Agolli, Abdullah Krashnica etj.⁹⁰ U dënua në Shqipëri edhe Xhafer Vokshi.

Trajtimi i Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe i Konferencës së Bujanit nga ana e historiografisë

Edhe Lidhja e Dytë e Prizrenit edhe aktet e Konferencës së Bujanit gjatë shekullit njëzetë janë trajtuar njëanshëm nga ana e historianëve, publicistëve e politikanëve sllavë. Nga ana e studiuesve shqiptarë të Kosovës, gjatë kësaj kohe Lidhja e Dytë e Prizrenit është trajtuar shumë pak për arsye të njohura. Kurse ndaj Konferencës së Bujanit varësish se si sillej situata politike, janë bërë përpjekje madje edhe serioze për ndriçimin e saj. Sa i përket institucioneve të Republikës Socialiste të Shqipërisë mjafton të paraqesim vendin që i është dhënë këtyre dy organizmave në Fjalorin Enciklopedik Shqiptar të botuar prej Akademisë së Shkencave të RPSH-së në Tiranë më vitin 1985.⁹¹ Aty bëhet fjalë për Konferencën e Bujanit, kurse për Lidhjen e Dytë të Prizrenit nuk bëhet fjalë. Në botimin e ri të Fjalorit Enciklopedik Shqiptar e botuar po nga kjo Akademi, Lidhja e Dytë e Prizrenit është e përfshirë së bashku me Konferencën e Bujanit.⁹² Por rrethanat e reja të krijuara në Shqipëri pas vitit 1992 dhe në Kosovë në vitin 1999 u mundësua që historiku i Lidhjes së Dytë të Prizrenit dhe Konferencës së Bujanit të ndriçohen në detaje.

⁹⁰ Alban Dobruna, *Konferenca e Bujanit...*, 96.

⁹¹ *Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e RPSH-së*, Tiranë, 1985, 536-537.

⁹² *Fjalor Enciklopedik Shqiptar, Akademia e Shkencave e RPSH-së*, Tiranë, 2008, 1298, 1508-1509.

Shteti shqiptar dhe Kosova për Lidhjen e Dytë të Prizrenit dhe për Konferencën e Bujanit

Kulla e Sali Manit ku është mbajtur Konferenca e Bujanit, është shpallur monument i mbrojtur nga shteti. Në Kosovë Këshilli Popullor Krahinor në mbledhjen e vet solemne më 30 dhjetor 1958 mori vendim për themelimin e “Shpërblimit të dhjetorit”.⁹³ Në Prizren në vitin 2001 është ngritur edhe çështja e hapjes së Muzeut të Lidhjes së Dytë të Prizrenit në sallën e shkollës “Bajram Curri”, aty ku është themeluar organizata Lidhja e Dytë e Prizrenit. Objekti i kësaj shkolle është monument i mbrojtur me ligj.⁹⁴ Të dy këto organizma shqiptare nuk do të kenë përkrahje të faktorëve të jashtëm vendimmarrës. Lidhja e Dytë e Prizrenit u goditë nga armatat partizane serbe, malazeze, bullgare, sllavo-maqedonase dhe disa brigada të tjera partizane. Forcat e Lidhjes së Dytë në nëntor të vitit 1944 duke parë se ishte e pamundur t’u bëhej qëndresë armiqve me urdhër nga zyrtarët e saj u tërhoqën nga luftimet frontale për të zhvilluar qëndresën guerile. Kurse vendimet e Konferencës së Bujanit u anuluan nga vetë qarqet jugosllave me të cilët kreatorët e Konferencës së Bujanit ishin në aleancë dhe luftuan së bashku jo vetëm kundër forcave nazifashiste, por edhe të disa forcave nacionaliste shqiptare.

⁹³ Hakif Bajrami, Kosova prej Bujanit..., 283.

⁹⁴ Parim Kosova, “Pse duhet të ngritet Muzeu i Lidhjes së Dytë të Prizrenit”, 126, në prof. Hazir Shala, Lidhja e Dytë e Prizrenit, Sesion shkencor, Prishtinë, 2015.